

UDHËZIM
Nr. 3, datë 12.2.2019

PËR ZHVILLIMIN E TESTIMIT TË NXËNËSVE TË KLASAVE TË BASHKUARA
II-IX TË ARSIMIT BAZË 2019

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të germës “a” të pikës 2 të nenit 26 të ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe vendimit nr. 505, datë 13.9.2017, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë”,

UDHËZOJ:

1. Zhvillimin e testimit të nxënësve të klasave të bashkuara II-IX, të arsimit bazë 2019, më datë 19 shkurt 2019.

2. Testimi i nxënësve të klasave të bashkuara II-IX, të arsimit bazë fillon në orën 10:00 dhe zgjat 45 minuta.

3. Testimi i nxënësve të klasave të bashkuara II-IX, të arsimit bazë 2019 është një vlerësim i njohurive gjuhësore të nxënësve, në leximin dhe shkrimin e gjuhës shqipe.

4. Institucionet arsimore vendore përgjegjëse për arsimin parauniversitar (DAR/ZA) të caktojnë numrin e administratorëve përgjegjës për zhvillimin e testimit të nxënësve të klasave të bashkuara II-IX për çdo institucion arsimor, ku do të zhvillohet testimi.

5. Në çdo njësi arsimore vendore përgjegjëse për arsimin parauniversitar, procesi i testimit të nxënësve të klasave të bashkuara të arsimit bazë II-IX monitorohet nga përfaqësuesit e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR).

6. MASR-ja monitoron edhe procesin e tërheqjes dhe shpërndarjes së materialeve të provimit nga QSHA-ja në DAR/ZA-të përkatëse një ditë para zhvillimit të testimit.

7. Përfaqësuesit e MASR-së përcaktohen me urdhër të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

8. Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA) kryen detyrat si më poshtë:

a) Harton testin e standardizuar dhe skemën e vlerësimit;

b) Shumëfishon dhe paketon të gjitha materialet e testimit dhe bën shpërndarjen e tyre;

c) Përpunon të dhënat dhe përgatit raportin mbi arritjet e nxënësve në testim.

9. DAR/ZA-ja kryen detyrat si më poshtë:

a) dërgon në QSHA listën e institucioneve arsimore që kanë klasa të bashkuara dhe numrin e nxënësve për çdo klasë;

b) tërheq nga QSHA-ja materialet e testimit një ditë përpara zhvillimit të testimit;

c) cakton administratorët përgjegjës për çdo institucion arsimor ku do të kryhet testimi i nxënësve të klasave të bashkuara II-IX;

d) udhëzon administratorët përgjegjës të çdo institucioni arsimor të caktojnë administratorët e testimit për çdo klasë dhe të menaxhojë në kohë shpërndarjen dhe grumbullimin e testeve të nxënësve;

e) organizon dhe kryen procesin e vlerësimit të testeve;

f) mban përgjegjësi për ruajtjen e sekretit dhe sigurimin e testeve deri në përfundim të procesit;

g) përcjell në QSHA testet e vlerësuara brenda datës 29 shkurt 2019;

h) kryen pagesën e vlerësuesve të testeve sipas legjislacionit në fuqi.

10. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe institucionet arsimore vendore përgjegjëse për arsimin parauniversitar.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT, SPORTIT
DHE RINISË
Besa Shahini